



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 03.11.2022

Nr: 203

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË KOMITETIT PËRFAQËSUES TË NISMËS
LIGJVËNËSE TË ZGJEDHËSVE, PËR REGJISTRIMIN E NISMËS LIGJVËNËSE
TË ZGJEDHËSVE “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10019,
DATË 29.12.2008 “KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 19, pika 2 dhe 71, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 14, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidateve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N

Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, me përfaqësues të nismës ligjvënëse të zgjedhësve z. Kristaq Kume, Qendra për Progres Rinor – Kukës me përfaqësues z. Lavdërim Shehu, Shoqata “Hapa të Lehtë” – Shkodër me përfaqësues zj. Denada Shpuza, Shoqata “Komuniteti Malazes në Shqipëri” – Elbasan me përfaqësues z. Marinko Cullafiq, Qendra “Tamara” – Tiranë me përfaqësues zj. Liridona Hoxha, Qendra për Zhvillim të Shoqërisë Civile – Durrës me përfaqësues zj. Mirjam Reçi, Forumi “Mendimi i Lirë” me përfaqësues z. Mentor Kikia dhe Shoqata “Zëri Qytetar” – Lushnjë me përfaqësues zj. Denada Korreshi, kanë paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën për pajisje me fletë tip për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa

ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 142, datë 08.04.2022 vendosi miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën ligjvënese të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”. Vendimi i sipërcituar përcaktoi afatin 3 (tre) mujor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi për mbledhjen e nënshkrimeve.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar kërkesa me nr. 21 prot., datë 17.06.2022, administruar nga KQZ me nr. 2738 prot., datë 20.06.2022, për shtyrjen e afatit të përcaktuar në vendimin nr. 142, datë 08.04.2022 të Komisionerit. Me vendimin nr. 175, datë 28.06.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi, të zgjasë afatin për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse të nevojshme, nga komiteti përfaqësues i nismës ligjvënese deri në datën 30 Tetor 2022.

Më datë 14.10.2022, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është administruar shkresa me nr. 3378 prot., me lëndë “Dorëzim i fletëve tip për grumbullimin e firmave mbështetëse”, si dhe dy dosje me formularët tip për mbledhjen e nënshkrimeve. Më datë 26.10.2022, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është administruar shkresa me nr. 3426 prot., me lëndë “Dorëzim i fletëve tip për grumbullimin e firmave mbështetëse”, nëpërmjet së cilës janë dërguar dhe formularët e firmosur nga 794 zgjedhës.

Referuar nenit 14, pika 1, të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënese të Zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”, me depozitimin e fletëve të mbledhjes së nënshkrimeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon nënshkrimet si dhe saktësinë e dokumenteve identifikuese të mbështetësve të nismës, sipas procedurave të parashikuara në Kodin Zgjedhor për verifikimin e nënshkrimeve dhe në legjislacionin në fuqi për nënshkrimin elektronik, brenda 30 ditëve nga depozitimi i tyre dhe merr një nga vendimet e mëposhtme:

- a) regjistron nismën ligjvënese të zgjedhësve;
- b) cakton një afat kohor për plotësimin ose korigjimin e pasaktësive të nënshkrimeve;

- c) refuzon regjistrimin e nismës nëse nga verifikimi rezulton se numri i nismëtarëve që kanë mbështetur nismën, duke depozituar identitetin dhe firmat e tyre, është më i vogël se 20 000 zgjedhës.

Në referim të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, Komisioneri ftoi përfaqësuesit e komitetit nismëtar, për të qenë prezent në seancën publike për verifikimin e numrit të nënshkrimeve.

Në mbështetje të sa më sipër cituar, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka bërë verifikimin e 5 për qind, të numrit të nënshkrimeve si dhe saktësinë e të dhënave të dokumenteve identifikuese të mbështetësve të nismës, brenda afatit ligjor të parashikuar. Në total janë depozituar 913 fletë, me 22 669 nënshkrime. Në referim të nenit 4, pika 2 të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë”, kërkohet që nisma ligjvënëse të nënshkruhet nga jo më pak se 20 000 zgjedhës. Ka rezultuar se numri i zgjedhësve të cilët kanë mbështetur nismën e plotëson numrin prej 20 000 zgjedhësish të kërkuar nga ligji.

Përsa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nënshkrimet e depozituara nga përfaqësuesit e nismës ligjvënëse për të propozuar projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, janë dorëzuar në përputhje me kërkesat e ligjit dhe si të tilla duhet të pranohen.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 2 dhe 71 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 14, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

V E N D O S:

1. Regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 03.11.2022
Nr. 203

“Për shqyrtimin e kërkesës së komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse të zgjedhësve, për regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”